



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-152
Prishtinë, 6, 7 dhe 11 shkurt 2014

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6, 7 DHE 11 SHKURT 2014**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Salih Morina, Donika Kadaj-Bujupi, Glauk Konjufca, Vesna Mikiq, Xhevahire Izmaku, Sadri Ferati, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Jakup Krasniqi, Vjosa Osmani, Zenun Pajaziti, Shaip Muja, Sala Berisha-Shala dhe ministrat Vlora Çitaku dhe Fadil Ismajli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që për rendin e ditës së punimeve të mbledhjes së sotme, pika - Koha për pyetje parlamentare, të renditet si pikë e fundit. Fjala e plotë e deputetit Ismet Beqiri është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimin e deputetit Ismet Beqiri, kryetari kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e lartpërmendur, u deklaruan deputetët: Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Ismet Beqiri.

Kuvendi nëpërmjet një votimi me ngritje dore e miratoi propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin që pika - Koha për pyetje parlamentare, të renditet si pikë e fundit e rendit të ditës.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
3. Debat parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
7. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
8. Emërimi i një (1) anëtarë në Bordin e RTK-së,
9. Zgjedhja e Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
10. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
12. Koha për pyetje parlamentare.

* * *

2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur me 30 janar 2014 pa asnjë vërejtje.

3. Debat parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Në vazhdim, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Lirije Kajtazi tha se Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se ngjarjet e fundit e kanë dëmtuar shumë imazhin e universitetit më të madh e më të njohur në vend dhe se ato janë pasojë e ndërhyrjeve sistematike të koalicionit qeverisës, por LDK-ja mendon se në funksion të stabilizimit të gjendjes kontributin duhet ta japim të gjithë. Gjithashtu, konsiderojmë se edhe protesta si një e drejtë kushtetuese nuk duhet të ndikohet nga ndërhyrjet politike të cilitdo subjekt, qoftë qeveritar, apo edhe opozitar.

Universiteti i Prishtinës përgjatë dekadave ka qenë institucioni më i rëndësishëm i arsimit të lartë në Kosovë dhe burim kryesor i dijeve në vendin tonë. Si institucion i parë dhe më i madh i këtij niveli, universiteti ishte prijës në fushën e arsimit dhe shkencës, vend nga kanë dalë njerëzit e dijes së Kosovës dhe drejtues edhe të fateve të vendit tonë.

Por, gjatë viteve të fundit, Universiteti i Prishtinës po kalon nëpër vështirësi të shumta të natyrës akademike dhe financiare dhe në kohë të fundit në pah kanë dalë dukuri, si marrja e mitos, gradimet shkencore jashtë kritereve dhe politizim i skajshëm.

Nga këto dukuri ka derivuar një gjendje me veprime dhe pasoja të shumta. Regjistrimi jashtë kritereve i studentëve në Universitetin e Prishtinës është njëra nga dukuritë negative që është përcjellë gjatë këtyre viteve. Kjo dukuri është bërë fenomen nëpërmjet të cilit Qeveria ka tentuar ta ruajë qetësinë sociale, ndërkohë që për pasojë kemi rënien e cilësisë së studimit dhe të punës shkencore, si dhe krijimin e një problemi me ndikim afatgjatë dhe rritjen e diskrepancës ndërmjet të diplomuarve dhe tregut të punës.

Më pas, ajo u fokusua në disa të dhëna tjera që kanë të bëjnë me cilësinë e arsimit të lartë, nevojat, programet, kuadrin, rritjen e numrit të studentëve, rritjen e numrit të universiteteve publike, dhe performansën, siç tha ajo, të dobët menaxheriale në Universitetin e Prishtinës.

Deputetja Kajtazi shfaq bindjen se gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces duhet të angazhohen ta ruajnë kredibilitetin dhe integritetin e mësimdhënësve në universitet.

Në vazhdim, ajo paraqiti para Kuvendit propozim-rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për të cilat tha se do të pasurohen gjatë debatit që do të zhvillohet sot dhe do të harmonizohen bashkërisht nga të gjitha subjektet. Diskutimi i znj. Lirije Kajtazi, është dhënë i plotë në transkript.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës foli ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja.

Ramë Buja tha se çështja në Universitetin Publik të Prishtinës ka rrugëzgjdhje, ka mundësi që këto çështje dhe këto probleme të tejkalohen.

Jam deklaruar edhe publikisht se kjo gjendje më ka trazuar shumë dhe më ka gëzuar njëkohësisht, kjo por faktin se një herë do të duhej filluar që kjo ployë dhe ky pështjellim të zgjidhet.

E dimë bashkë pse është kështu, pa dashur të sqaroj, sepse në fakt gjërat kanë shkuar gjer aty sa do të duhej që të shihen nga të gjitha rrafshet, nga të gjithë prizmat. Unë jam po kështu i bindur që do t'i përmbahemi një thënieje, le të më falë autori nëse nuk e citoj besnikërisht, por kuptimisht besoj po që e gjejmë diku në "Kështjellën" e Ismail Kadaresë, ku thuhet që: "mallkuar qoftë ai njeri dhe ai popull që e mallkon vendin ose burimin prej nga ka dalë".

Unë jam i sigurt për këtë, për faktin që debati do të jetë në funksion të asaj që ne të dalim bashkë nga kriza, për t'ia kthyer kredibilitetin institucionit që ishte dhe duhet të mbetet kredibil.

Në vazhdim, ai theksoi se ministria që ai udhëheq i ka bërë të gjitha detyrat që i takojnë me ligjin që është aprovuar në këtë Parlament. E kam thirrur jo një herë Këshillin Drejtues që është mekanizëm menaxherial dhe i kam sugjeruar që ata këtë gjendje të krijuar ta menaxhojnë në atë formë të logjikshme dhe legale. Dhe, natyrisht, që sugjerimi im ka qenë që t'i marrin hapat që janë ndërmarrë për t'i sugjeruar institucionit kredibil akademik - Senatit, që të marrë hapat që ka marrë, për të vlerësuar të gjitha këto gjëra që kanë ndodhur në universitet, duke vlerësuar edhe punimet shkencore në atë nivel akademik, sepse ne të tjerët nuk kemi të drejtë, ashtu siç as gazetarët nuk e kanë të drejtën e vlerësimit të punimeve shkencore në nivel akademik.

Unë ju zotohem këtu para jush që unë do t'i bëj të gjitha detyrat që më shtrohen edhe në bazë të sugjerimeve dhe rekomandimeve që do të dalin nga ky debat, me synimin për të dalë nga kriza dhe natyrisht do t'i mbaj të gjitha përgjegjësitë që më takojnë për të gjitha situatat, edhe këtë situatën e fundit të krijuar.

Çështja është se kërkohet gjithmonë që politika të mos jetë e pranishme në universitet, tha ministri Buja.

Ai, në fund, i ftoi deputetët për debat konstruktiv dhe përmbajtjesorë. Diskutimi i z. Ramë Buja, është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari, më pas, e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Ramë Vataj, në emër të GP të PDK-së; Afrim Kasolli, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të GP të KKR-së; si dhe Ramiz Lladrovci, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi, Albulena Haxhiu, Fadil Demaku, Eqrem Kryeziu, Burim Ramadani, Rexhep Selimi, Skender Hyseni, Xhevahire Izmaqi, Gëzim Kelmendi, Aurora Bakalli, Muhamet Mustafa, Halit Krasniqi, Glauk Konjufca, kryeministri Hashim Thaçi, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Kymete Bytyçi, Time Kadrijaj, Faton Topalli, Emilija Rexhepi, Armend Zemaj, Berat Buzhala, Haki Demolli, Shaip Muja, Sadri Ferati, Duda Balje, Nazane Breca, Justina Pula-Shiroka, Amir Ahmeti, Xhafer Tahiri, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Hydajet Hyseni, Vjollca Krasniqi, Blerta Deliu-Kodra, Arsim Bajrami, Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript. Deputetja Blerta Deliu-Kodra tha se pjesën tjetër të diskutimit të paraparë do ta dorëzojë me shkrim.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit e paraqiti tekstin e rekomandimeve, për miratim nga Kuvendi, për të cilat tha se janë të harmonizuara edhe me dy grupet tjera parlamentare opozitare.

Në lidhje me propozim-rekomandimet e paraqitura nga Ismet Beqiri, më pas u deklaruan edhe deputetët: Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së dhe Sevdije Lama, në emër të GP të KKR-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, grupet parlamentare të koalicionit qeverisës e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, i mbylli punimet e seancës në orën 18:30 minuta, për të vazhduar nesër, në orën 10:00.

* * *

E premte, 7 shkurt 2014
Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 6 shkurt 2014.

Në vazhdim, ai propozoi që pikat e rendit të ditës: Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare dhe Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të shqyrtohen në fillim të kësaj seance, për shkak të racionalizimit të kohës.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartpërmendur të kryetarit.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
4. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
5. Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.
6. Votimi i propozim-rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
10. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
11. Emërimi i një (1) anëtari në Bordin e RTK-së,
12. Koha për pyetje parlamentare.

* * *

3. Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Kuvendit ia ka parashtruar propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Kryesia e Kuvendit, mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t’i propozojë anëtarët e organit përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mbështetur në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, me vendimin nr. 06//2014, dt. 24 janar 2014 ia ka propozuar Kuvendit tre (3) gjykatës për Organin e Pavarur Përzgjedhës.

Më pas, ai e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Organit të Pavarur Përzgjedhës emërohen:

1. Valdete Daka, gjyqtare nga Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Asllan Krasniqi, gjyqtar nga Gjykata Themelore në Prishtinë,
3. Nebojsa Boriçiq, gjyqtar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

II. Kërkohet nga anëtarët e Organit të Pavarur Përzgjedhës që, mbështetur në nenin 100.4 të Ligjit nr. 03/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, ta shqyrtojnë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

4. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimet e Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartshënuar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Hatim Baxhaku emërohet anëtar i Komisionit parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetes Lirije Kajtazi.

2. Deputeti Xhavit Uka emërohet anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë, në vend të deputetit Imri Ahmeti.

3. Deputeti Xhafer Tahiri emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Imri Ahmeti.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

5. Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimet e Grupit Parlamentar SLS për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të SLS.

Kuvendi e miratoi propozimin e lartshënuar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Sreten Ivanoviq emërohet zëvendëskryetar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë, në vend të deputetit Vesimir Saviq.
2. Deputeti Hamza Balje emërohet zëvendëskryetar në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetit Sasha Gjokiq.
3. Deputeti Petar Miletiq emërohet anëtar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Etem Arifi.
4. Deputeti Mursel Haljilji emërohet anëtar në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të deputetit Milivoje Stojanoviq.
5. Deputeti Sasha Milosavleviq emërohet anëtar në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetes Vesna Mikiq.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

6. Votimi i propozim-rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Në fillim të procedimit me këtë pikë të rendit të ditës, kryetari i ftoi kryetarët apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i harmonizojnë propozim-rekomandimet lidhur me këtë debat.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare u tërhoqën në një sallë tjetër për harmonizimin e propozim-rekomandimeve.

Pas konsultës së mbajtur për harmonizimin e propozim-rekomandimeve, për fjalë u paraqitën deputetët: Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Ramë Vataj, në emër të GP të PDK-së; Suzan Novobërdaliu, në emër të GP Koalicionit Kosova e Re; diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari më pas konstatoi se propozim-rekomandimet e paraqitura nga Ismet Beqiri, në emër të grupeve parlamentare të opozitës dhe propozim-rekomandimet e paraqitura nga Ramë Vataj, në emër të grupeve parlamentare të pozitës, duhet të dorëzohen në Zyrën për Parashpresa dhe të njëjtat t'u shpërndahen deputetëve dhe të procedohet me këtë pikë në mbledhjen e radhës.

* * *

Kryetari në vazhdim theksoi se për procedimin e pikave të radhës nuk është e mundur, pasi në sallë nuk janë të pranishëm ministrat e dikastereve përkatëse për paraqitjen dhe arsyetimin e

projektligjeve, me gjithë faktin se ai kishte dhënë më herët një pauzë prej 30 minutave, në mënyrë që ministrat të jenë të pranishëm në Kuvend.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 11:45 minuta, për vazhdimin e së cilës do të vendoset në Kryesinë e Kuvendit të hënën.

E martë, 11 shkurt 2014

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 6 shkurt dhe të vazhduar me 7 shkurt 2014.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

6. Votimi i propozim-rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Në fillim të seancës, kryetari tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar. Sot duhet të procedohet me votimin e rekomandimeve të paraqitura nga parashtuesi i mocionit.

Ai e ftoi kryetarin e GP të LDK-së që t'i paraqesë rekomandimet.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, i paraqiti propozim-rekomandimet në emër edhe të dy grupeve parlamentare opozitare, ndërsa theksoi se dy propozim-rekomandimet e paraqitura nga GP i PDK-së janë inkorporuar në propozim-rekomandimet që ai i paraqiti.

Ai kërkoi që propozim-rekomandimet e paraqitura nga ai të hidhen në votim.

Diskutimi i z. Ismet Beqiri, është dhënë i plotë në transkript.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, kërkoi nga kryetarët e të gjitha grupeve parlamentare që t'i harmonizojnë propozim-rekomandimet, pasi, siç tha ai, ato janë të paharmonizuara.

Diskutimi i z. Adem Grabovci është dhënë i plotë në transkript.

Visar Ymeri, në emër të GP të VV-së, tha se i përkrah propozim-rekomandimet e paraqitura nga kryetari i GP të LDK-së.

Diskutimi i z. Visar Ymeri është dhënë i plotë në transkript.

Burim Ramadani, në emër të GP të AAK-së, tha se propozim-rekomandimet e paraqitura nga kryetari i GP të LDK-së janë të harmonizuara dhe se nga ajo që shihet, GP i PDK-së nuk ka paraqitur propozim-rekomandime të reja.

Diskutimi i z. Burim Ramadani është dhënë i plotë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim propozim-rekomandimet e paraqitura nga kryetari i GP të LDK-së lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 100 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara, me arsyetimin se në bazë të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese për të qenë një vendim valid, në votim duhet të marrin pjesë 61 deputetë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ministri Fadil Ismajli tha se çështje kryesore e trajtuar në këtë projektligj është neni 25 paragrafi 8,9 dhe 10 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Fadil Ismajli, është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Suzan Novobërdaliu, Hydajet Hyseni, Rita Hajzeraj-Beqaj dhe Nijazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Kryesuesi Sabri Hamiti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Ministri Dardan Gashi tha se ky projektligj do t’i përcaktojë rregullat për vendosjen, përditësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kombëtare, të procedurave dhe kushteve të përcaktimit të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, ai theksoi se ligji do të zbatohet për të gjitha meta-datat, grupet e të dhënave për informacionin hapësinor dhe shërbimet tjera brenda territorit të Kosovës. Në fund, ai i ftoi deputetët për miratimin në parim të projektligjit.

Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Kryesuesi Sabri Hamiti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Ministri Dardan Gashi tha se ky projektligj konsiderohet i nevojshëm për shkak se janë paraqitur probleme në zbatimin e tij.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Ministri Dardan Gashi tha se zhvillimi, rregullimi dhe shfrytëzimi i Parkut Nacional “Sharri” kërkon veprim të organizuar dhe të koordinuar të të gjitha strukturave të përfshira.

Funksionimi dhe themelimi i institucioneve të reja që merren me mjedisin, si në nivel qendror dhe në atë lokal, janë treguar si veprime të qëlluara në drejtim të arritjeve të dëshirueshme, por në të njëjtën kohë të pamjaftueshme.

Ekzistojnë dy drejtori që menaxhojnë me pasuritë e parkut, njëra e vendosur në Prizren, kurse tjetra në Shtërpçë, e cila menaxhon vetëm pjesën që është brenda kësaj komune, theksoi ministri.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen e këtij plani dhe ftoi deputetët për miratim të këtij plani.

Fjala e z. Dardan Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Mursel Haljilji, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Alma Lama, Visar Ymeri, Emilija Rexhepi, Nait Hasani dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,

Kundër ----- 12,

Abstenime ----- 10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

11. Emërimi i një (1) anëtari në Bordin e RTK-së

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari tha se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e

kandidatëve për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radha e komunitetit serb dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Xhevahire Izmaku, në emër të Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Xhevahire Izmaku,
2. GP LDK - Afërdita Berisha-Shaqiri,
3. GP Vetëvendosje - Albana Gashi,
4. GP AAK - Teuta Haxhiu,
5. GP - Koalicioni Kosova e Re - Jeton Svirca,
6. GP SLS - Jasmina Zhivković,
7. GP "6+" - Mufera Shinik.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Xhevahire Izmaku.

Ajo tha se rezultati i votimit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, është si në vijim:

1. Aleksandar Janiçević ka fituar 50 vota,
2. Milena Gjeriq ka fituar 15 vota.

Të pavlefshme janë 19 fletëvotime.

Më pas, kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

1. Z. Aleksandar Janiçević emërohet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

12. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri tha se ka marrë përgjigje në formë të shkruar në pyetjen me shifrën DO-2085, që ajo kishte parashtruar për ministrin Dardan Gashi.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a do të duhej që Ministria e Shëndetësisë të nxjerrë një propozim-strategji kombëtare lidhur me parandalimin e fenomenit të vetëvrasjeve në Kosovë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaku.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me masat që i ka ndërmarrë ministria e Drejtësisë për parandalimin e mbajtjes së zgjedhjeve nga Qeveria e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale